



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 31.68/2 Prot

Gramsh më.....01.09.2022
08.2022

V E N D I M

Nr. 59, datë 31.08.2022

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
DHE PJESËMARRJEN E BASHKISË GRAMSH NË SUBJEKTIN ME KOMPETENCA TË
PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË
PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA”**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave 302 datë 11.05.2022 “Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”, Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve datë 27.07.2022 lidhur ndërmjet Bashkisë Gramsh dhe MIE dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Cërrik, Belsh dhe Peqin, pasi shqyrtoi përmbajtjen dhe kushtet e parashtruara në marrëveshje , me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Të miratojë Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve datë 27.07.2022 lidhur ndërmjet Bashkisë Gramsh dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë(MIE) dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Cërrik, Belsh dhe Peqin.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Gramsh”sh.a(UK) që në përputhje me kushtet dhe dakordësinë e arritur në Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve datë 27.07.2022,që pas krijimit të Subjektit me Kompetenca të Përbashkëta , ku bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve të autorizimit për Administratorin e shoqërisë Aksionare “Ujësjellës Kanalizime Gramsh”sh.a(UK), për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktor dhe noterial me qëllim transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë asetet që aktualisht shoqëria ka, për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet .
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë .

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI

Konc.Xh.Gjini

Miratoi G.Lena

Dosja _____

Afati _____

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Greta LENA

